

## NË EMËR TË POPULLIT

**Gjykata e Apelit e Kosovës** – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Gani Zabeli, kryetar kolegji, Shqipe Qerimi e Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Vjollca Kurtishaj, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.SH. nga fshati ...,komuna e Suharekës, për shkak të kryerjes së dy veprave penale sulm nga neni 187 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit L.SH., av. B.B., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, P.nr.498/18 të datës 22.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.02.2019, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit L.SH., av. B.B., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, P.nr.498/18 të datës 22.11.2018, **vërtetohet**.

### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, P.nr.498/18 të datës 22.11.2018, të akuzuarin L.SH., e ka shpallur fajtor për shkak të kryerjes së dy veprave penale sulm nga neni 187 par.1. të KPRK-së dhe të njëjtin e ka gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, për veprën penale nga dispozitivi I i aktgjykimit të ankimuar ndërsa për veprën penale nga dispozitivi II i të njëjtit aktgjykim, e ka gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve dhe me aplikimin e dispozitës së nenit 80 të KP, të akuzuarit i ka shqiptuar dënim unik me 6 (gjashtë) muaj burg. Gjykata e shkallës së parë, me pëlqimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, dënimin me burg të akuzuarit ia ka zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 3.000 (tre mijë)€, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe në këtë dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 23.10.2018 deri më 22.11. 2018, ku një ditë e kaluar në paraburgim do ti llogaritet 20 €. Të dëmtuarit XH.SH. nga fshati ... dhe B.A.Z. nga fshati ..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil. Është obliguar i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20(njëzet)€ si dhe është obliguar të paguaj shumën prej 30€, në emër të taksës për kompensimin e viktimave të kimit, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Me të njëjtin aktgjykim, gjykata e shkallës së parë konform nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPP, ka refuzuar akuzën ndaj të akuzuarit për kryerjen e

veprës penale kanosje nga neni 185 par.2 të KPRK për shkak se Prokurori ka hjekë dorë nga akuza.

Kundër këtij aktgjykimi mbrenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit L.SH., av. B.B., për shkak të vendimin mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit ta miratoj ankesën si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar, ta ndryshojë dhe ndaj të akuzuarit të shqiptojë një dënim më të butë me gjobë.

Prokurori i Apelit me parashtrësën me shkrim, PPA/II.nr.59/2018, datës 05.02.2019, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit ndërsa aktgjykimi i ankimuar, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

**- ankesa nuk është e bazuar.**

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPP dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit.

Po ashtu, as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, në fakt me ankesë as që ka mund të kontestohet ngase i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë dhe gjyqtari individual është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj aktgjykimi i kundërshtuar u vlerësua vetëm në drejtim të pretendimeve të paraqitura në ankesë.

Mbrojtësi i të akuzuarit me ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin nuk i ka vlerësuar drejtë rrethanat lehtësuese të cilat do të ndikonin që të mbrojturit të tij ti shqiptohej një dënim më i butë meqenëse i akuzuari është i gjendjes së dobët ekonomike, nuk ka të themeluar marrëdhënie të rregullte pune, nuk realizon të ardhura të rregullta pune, se të ardhurat e vetme që i realizon për mbajtjen e familjes së tij pesë anëtarësh është kontraktimi i ndonjë marrëveshjeje për të bërë muzikë me sint. Sipas ankesës, dënimi i shqiptuar në rastin konkret nuk është në proporcion me peshën e veprës, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, me sjelljen dhe rrethanat e kryerësit si dhe me intensitetin e rrezikimit.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit për një dënim më të butë, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit në mënyrë të plotë dhe gjithë përfshirëse i ka konstatuar dhe drejt i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në pajtim me dispozitat e nenit 73 dhe 74 të KPRK, duke i vlerësuar si rrethana lehtësuese faktin se i

akuzuari ka bërë pranimin e fajësisë, se ka qenë korrekt në gjykatë, se është familjar , se është penduar për veprat e kryera dhe se është i gjendjes së dobët.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar drejtë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të lartcekura dhe se në ankesën e të akuzuarit nuk theksohet asnjë rrethanë lehtësuese e cila nuk është vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë e që do të ndikonte në zbutjen e dënimit të shqiptuar ndaj të akuzuarit.

Prandaj, duke pas parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka konstatuar dhe drejt vlerësuar gjykata e shkallës së parë, si dhe duke pasur parasysh se është fjala për dy vepra të njëjta, edhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale dhe adekuat me përgjegjësinë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit- preventiva individuale dhe ajo e përgjithshme.

Nga sa u tha më lartë në pajtim më dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – PRISHTINË**  
**PA1.nr.37/19 me 22.02.2019**

**Bashkëpunëtorja profesionale**  
**Vjollca Kurtishaj**

**Kryetari i kolegjit - gjyqtari,**  
**Gani Zabeli**

**Anëtarët e kolegjit:**

**Shqipe Qerimi**

**Afrim Shala**